

Transformimi i Gjelbër i Ndërmarrjeve
Private Në Kosovë (GPEK)

FONDI PËR INOVACION

**THIRRJE PËR
PROPOZIME
CFP-2026-01**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS
KOSOVO

Transformimi i Gjelbër i Ndërmarrjeve Private në Kosovë (GPEK), është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i bashkëfinancuar nga Suedia dhe i zbatuar nga Helvetas.

Transformimi i Gjellbër Ndërmarrjeve
Private në Kosovë (GPEK)

FONDI PËR INOVACION

THIRRJE PËR PROPOZIME # CFP-2026-01

Publikuar nga:	Projekti për Transformimin e Gjellbër të Ndërmarrjeve Private në Kosovë
Data e publikimit:	20 korrik 2026
Afati i fundit:	31 janar 2027, ora 16:00 CET. <u>Inkurajohet fuqishëm aplikimi i hershëm.</u>
Lënda:	Ftesë për subjektet e kualifikuara që të dorëzojnë Shprehje të Interesit (ShI) për financim të partneritetit që synon trajtimin e pengesave sistematike financiare të cilat e kufizojnë inovacionin e gjellbër të Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) në Kosovë.
Pranueshmëria:	Aplikuesit duhet të jenë NVM të regjistruara ligjërisht në Kosovë për së paku dy vjet.
Financimi:	Grantet do të jenë nga 50,000 EUR deri në maksimum 100,000 EUR. Grantet nën 50,000 EUR mund të merren në konsideratë në rrethana të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara mirë.
Informacionet:	Orari i veçantë i sesionit(eve) informues(e) do të publikohet në faqet e Helvetas Kosovo në Facebook dhe LinkedIn. Pyetjet eventuale lidhur me aplikim të dërgohen në emailin gpekgrants@helvetas.org .
Aplikimi:	Aplikuesit duhet t'i dorëzojnë ShI-të e plotësuar ekipit të Fondit për Inovacion të GPEK në mënyrë elektronike në gpekgrants@helvetas.org me lëndën: Aplikimi CFP#1 – Emri i aplikantit.

1. Historiku i Fondit për Inovacion

Projekti për Transformimin e Gjelbër të Ndërmarrjeve Private në Kosovë (GPEK) synon të rrisë konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e NVM-ve në Kosovë, duke mbështetur kalimin e tyre drejt teknologjive dhe praktikave të biznesit më të pastra dhe më efikënte në përdorimin e burimeve. Në kuadër të këtij projekti, Fondi për Inovacion është konceptuar si një mekanizëm katalitik financimi, i cili u mundëson ndërmarrjeve të testojnë, të përvetësojnë dhe të zgjerojnë zgjidhje inovative të gjelbra. Ndryshe nga skemat tradicionale të granteve, Fondi për Inovacion funksionon sipas parimit të bashkëinvestimit, që do të thotë se nuk i financon plotësisht aktivitetet e biznesit, por ndan rreziqet me akterët e sektorit privat, me qëllim të nxitjes së investimeve në fusha që mund të mos jenë ende plotësisht të qëndrueshme nga pikëpamja komerciale, por që dëshmojnë potencial të lartë për ndikim si në biznes, ashtu edhe në mjedis.

2. Qëllimi i thirrjes

Objekti i kësaj thirrjeje është të mbështesë investimet e gjelbra inovative dhe të orientuara nga tregu të NVM-ve në Kosovë. Ajo synon t'i nxisë bizneset të shqyrtojnë qasje të reja që përmirësojnë performancën mjedisore dhe konkurrueshmërinë. Propozimet duhet:

- Të prezantojnë dhe/ose të zgjerojnë përdorimin e teknologjive ose proceseve të qëndrueshme në aspektin mjedisor;
- Të përmirësojnë efikasitetin në përdorimin e burimeve dhe të sjellin ndikim të matshëm (p.sh. reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe kursimin e energjisë);
- Të mbështesin përputhshmërinë me standardet e reja të gjelbra ose të krijojnë mundësi të reja biznesi të ndërlidhura me qëndrueshmërinë;
- Të dëshmojnë potencial për t'u përsëritur, duke ndikuar tek akterët e tjerë të tregut përmes efektit demonstrues..

3. Fushat prioritare për financim

Përmes kësaj thirrjeje për financim, GPEK mirëpret aplikime inovative dhe me ndikim, të cilat avancojnë në mënyrë të dëshmueshme inovacionin e gjelbër të NVM-të, nxisin ndryshime sistematike brenda sektorëve përkatës dhe kontribuojnë në mënyrë të matshme në arritjen e rezultateve të pritshme të programit. Aktivitetet specifike të propozuara nga aplikuesit mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, ofrimin e zgjidhjeve në fushat e mëposhtme:

- *Konkurrueshmëria e gjelbër dhe qasja në treg* - përgatitja e NVM-ve për pajtueshmëri dhe certifikim në përputhje me kriteret ESG, duke përfshirë mbështetjen për etiketimin ekologjik, standardet e qëndrueshmërisë dhe pajtueshmërinë për eksport; sistemet digjitale të gjurmueshmërisë dhe prodhimit, duke përfshirë mjetet për

gjurmimin e zinxhirëve të furnizimit dhe përmbushjen e kërkesave të blerësve; efikasitetin në përdorimin e burimeve dhe përvetësimin e praktikave të ekonomisë qarkore; avancimin e furnitorëve për integrim në zinxhirët e vlerës së BE-së etj.

- *Ekosistemet e inovacionit dhe platformat e bashkëpunimit* - qendrat e inovacionit të gjelbër dhe nismat pilotuese; zhvillimi i grupimeve në sektorët kyç, si agroushqimi dhe prodhimtaria; bashkëpunimi ndërmjet universiteteve dhe industrisë për kërkime të aplikuara; si dhe platformat digjitale për shkëmbimin e njohurive dhe krahasimin e performancës;
- *Financat e gjelbra dhe mobilizimi i investimeve* - programet për përgatitjen e NVM-ve për investime, duke përfshirë planifikimin e biznesit, raportimin ESG dhe edukimin financiar; produktet financiare në përputhje me kriteret ESG, duke përfshirë mbështetjen për bankat në zhvillimin e kredive të gjelbra dhe financimit të bazuar në performancë; financimin e kombinuar dhe mekanizmat për bashkëndarjen e rrezikut, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut të investimeve të gjelbra për ndërmarrjet më të vogla; si dhe platformat për ndërgjegjësim dhe ndërmjetësim, të cilat lidhin ndërmarrjet me institucionet financiare dhe investitorët.
- *Mjedisi i biznesit dhe reforma e politikave për rritje të gjelbër* - thjeshtimi i sistemeve të certifikimit, lejeve dhe inspektimit; mbështetja për zbatimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) dhe të kornizave të etiketimit ekologjik; platformat e dialogut publiko-privat; vlerësimet e ndikimit rregullator; si dhe harmonizimi i politikave me standardet e Bashkimit Evropian (BE).
- *Rritja e gjelbër gjithëpërfshirëse dhe mbështetja për gratë dhe grupet e nënperfaqësuar* - mbështetja e synuar për ndërmarrjet e drejtuara nga gratë dhe ndërmarrjet në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë për qasje në tregjet dhe financat e gjelbra; programet e përshtatura për ngritjen e kapaciteteve dhe mentorim; nismat gjithëpërfshirëse të inovacionit; eliminimi i pengesave strukturore për pjesëmarrje në sektorët e gjelbër; si dhe promovimi i qasjes së barabartë në zhvillimin e shkathtësive, punësim dhe mundësi udhëheqëse në ekonominë e gjelbër.

4. Aplikuesit e pranueshëm

Kjo thirrje është e hapur për **NVM-të e sektorit privat** të regjistruara në Kosovë, të cilat dëshmojnë potencial për inovacion dhe kapacitet për të bashkëinvestuar në rritjen e tyre.

Kërkesat themelore të pranueshmërisë

Për t'u kualifikuar, aplikantët (duke përfshirë partnerët) duhet:

- Të jenë të regjistruar ligjërisht dhe të veprojnë aktivisht në Kosovë për së paku dy vjet;
- Të kenë kapacitete themelore për menaxhim financiar dhe operacional;
- Të jenë në gjendje ta zotohen për kontributin e kërkuar në para për bashkëfinancim.

Kapaciteti minimal organizativ dhe financiar

NVM-të e pranueshme duhet të dëshmojnë si në vijim:

Kapaciteti operacional

- Staf të kualifikuar menaxhues dhe teknik, të aftë për realizimin e aktiviteteve të projektit;
- Sisteme funksionale të menaxhimit financiar dhe kontrole të brendshme;
- Të dhëna financiare të disponueshme dhe të verifikueshme për së paku dy vitet e fundit;
- Llogari bankare aktive dhe të verifikueshme;
- Aftësi për t'i menaxhuar fondet e grantit në përputhje të plotë me kërkesat e donatorit;
- Kapacitet të dëshmuar për mbrojtjen e aseteve, parandalimin e keqpërdorimit të fondeve dhe zbatimin efektiv të aktiviteteve.

Përputhshmëria strategjike dhe programore

NVM-të e pranueshme duhet gjithashtu të dëshmojnë:

- Përputhshmëri të qartë me objektivat e Fondit për Inovacion të GPEK dhe Taksonominë e Western Balkan 6 (WB6);
- Kontribut në inovacionin e gjelbër, qëndrueshmërinë mjedisore dhe zhvillimin e tregut;
- Investimi është në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi;
- Teknologjia ose procesi i propozuar nuk paraqet rreziqe të konsiderueshme mjedisore;
- Janë përfshirë masat përkatëse zbutëse aty ku ekzistojnë ndikime të mundshme.

5. Aplikuesit e papranueshëm

Aplikantët që nuk janë të pranueshme për mbështetje nga Fondi për Inovacion përfshijnë:

- Subjektet dhe individët e përfshirë në mashtrim, korrupsion, pastrim të parave, financim të terrorizmit ose veprimtari të tjera të paligjshme, shkelje të të drejtave të njeriut apo praktika joetike të biznesit;
- Subjektet e përfshira në listat ndërkombëtare të sanksioneve (Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), BE, Zvicër);
- Subjektet që më parë kanë keqpërdorur fondet e SDC-së ose SIDA-s;
- Subjektet që promovojnë agjenda antidemokratike ose veprimtari të paligjshme;
- Partitë politike ose institucionet e lidhura me to;
- Subjektet që synojnë t'i përdorin fondet për qëllime fetare dhe/ose
- Organizatat me konflikt interesi, përfshirë lidhjen me HELVETAS-in.

‘Greenwashing’ (Pretendime të rreme mjedisore) - Aplikantët që angazhohen në greenwashing nuk do të jenë të pranueshëm për mbështetje. ‘Greenwashing’ i referohet pretendimeve të rreme, mashtruese, të ekzagjeruara ose të pambështetura lidhur me

karakteristikat ose përfitimet mjedisore të një investimi. Pretendimet mjedisore duhet të mbështeten me dokumentacion teknik objektiv dhe metodologji të njohura të llogaritjes. Investimet për të cilat përfitimet e pretenduara mjedisore nuk mund të vërtetohen do të refuzohen.

6. Vlera e grantit

Varësisht nga disponueshmëria e fondeve, grantet që rezultojnë nga kjo mundësi financimi pritet të jenë në vlerën:

- **50,000 EUR –100,000 EUR.**
- Grantet nën 50,000 EUR mund të merren në konsideratë në rrethana të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara mirë.
- Fondi për Inovacion mbulon deri në 70% të kostove të pranueshme të projektit. Aplikuesit duhet të kontribuojnë së paku 30% në para. Kontributet në natyrë inkurajohen, por nuk mund ta zëvendësojnë kërkesën minimale për kontribut në para.
- Periudha e zbatimit të aktiviteteve të financuara është deri në 2 vjet.

Fondet mund të përdoren vetëm për investime produktive dhe aktivitete inovative. Nuk lejohet shlyerja ose pagesa e borxhit të çfarëdo lloji.

7. Kostot dhe aktivitetet e pranueshme

Për ta fuqizuar tranzicionin e gjelbër të aplikantëve të pranueshëm në Kosovë, GPEK dhe Fondi për Inovacion i inkurajojnë bizneset të dorëzojnë projekte investuese që mbulojnë aspektet në vijim.

- Teknologjitë e gjelbra, pajisjet dhe makineritë: blerja, instalimi dhe vënia në funksion e teknologjive të gjelbra, pajisjeve të prodhimit, teknologjive digjitale, sistemeve të energjisë së ripërtëritshme, pajisjeve me efikasitet energjetik, aseteve fikse me vlerë të ulët, materialeve dhe investimeve të tjera produktive që lidhen drejtpërdrejt me inovacionin e gjelbër të propozuar.
- Shërbimet e konsulencës dhe shërbimet e specializuara teknike (gjatë zbatimit të projektit): tarifat për ekspertë të jashtëm që ofrojnë shërbime të inxhinierisë dhe projektimit teknik, vlerësime mjedisore, mbështetje për certifikim, trajnime të specializuara, mbikëqyrje teknike, studime fizibiliteti, shërbime këshillimore ose ekspertizë tjetër të nevojshme për zbatimin e investimit të miratuar të gjelbër.
- Udhëtimet (kur lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit): shpenzimet për transport, akomodim dhe dieta, të nevojshme për aktivitete si trajnimet teknike, instalimi dhe vënia në funksion e pajisjeve, vizitat te furnitorët ose ofruesit e teknologjisë, proceset e certifikimit ose aktivitete të tjera të zbatimit që lidhen drejtpërdrejt me investimin e propozuar të gjelbër.
- Pajisje: pajisje digjitale, asete fikse me vlerë të ulët, materiale, etj.

- Ngjarjet, komunikimi dhe shpërndarja e rezultateve (kur lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit): qiraja e ambienteve, organizimi i punëtorive, konsultimet me palët e interesit, aktivitetet demonstrative, materialet e dukshmërisë së projektit, shtypja, publikimet, përkthimi, formatimi i dokumenteve,
- Certifikimet: GPEK mund të bashkëfinancojë certifikimin për herë të parë, ripërtëritjen e parë të certifikimit (deri në 50%) dhe ngritjen përkatëse të kapaciteteve/trajnimin e nevojshëm për të gjitha certifikimet, duke përfshirë ato pas ripërtëritjes së parë.

Investimet e pranueshme duhet të kontribuojnë në një ose më shumë aspekte të tranzicionit të gjelbër, duke përfshirë eficiencën e burimeve, zgjidhjet e ekonomisë qarkore, energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e energjisë, proceset e qëndrueshme të prodhimit, pajtueshmërinë mjedisore, certifikimin e gjelbër, teknologjitë me emetime të ulëta të karbonit ose inovacione të tjera që dëshmojnë performancë mjedisore dhe konkurrueshmëri të biznesit.

8. Kostot dhe aktivitetet e papranueshme

Të gjitha kostot e shkaktuara në kuadër të granteve të Projektit GPEK duhet të jenë të arsyeshme, të alokuar dhe të lejueshme, në përputhje me kushtet e marrëveshjes së grantit dhe parimet përkatëse të kostove. Kostot ose aktivitetet e papranueshme përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Kostot e personelit;
- Pijet alkoolike;
- Borxhet e këqija, gjobat dhe dënimet e shqiptuara ndaj përfituesit të grantit dhe çdo kosto juridike përkatëse;
- Kostot e argëtimit, përfshirë zbavitjen, aktivitetet rekreative dhe shoqërore, si dhe çdo kosto që lidhet drejtpërdrejt me to;
- Mbledhjen e fondeve, përfshirë fushatat financiare dhe fushatat për fondet e dhuruara, të krijuara vetëm për të mbledhur kapital ose kontribute;
- Mallrat ose shërbimet për përdorim personal të punonjësve të organizatës (përfshirë kostot e banimit, shtesat për banim dhe shpenzimet personale të jetesës);
- Armatimin, armët ose komponentët përkatës;
- Prodhimin ose tregtimin e duhanit, lojërat e fatit, kazinotë ose bastet;
- Pornografinë ose mediat raciste;
- Prodhimin e substancave të kufizuara ose të rrezikshme që nuk janë në përputhje me standardet mbrojtëse.
- Pagesat e interesit dhe kostot e tjera të huamarrjes nuk janë të pranueshme për mbështetje nga Fondi për Inovacion. Shpenzimet e pranueshme duhet të lidhen me aktivitetet e miratuara të projektit dhe të mbështeten me dokumentacion përkatës, pavarësisht nëse financohen nga fondet e grantit, burimet vetanake ose kreditë;
- Aktivitetet me karakter politik dhe aktivitetet e lidhura me ndonjë parti politike;

- Kostot e themelimit të organizatës, përfshirë tarifat e regjistrimit, tarifat e ndërmjetësve, avokatëve, këshilltarëve për investime etj.

9. Bashkëfinancimi

Aplikantëve u kërkohet të mbulojnë së paku 30% të kostove të zbatimit të aktiviteteve të propozuara të projektit. Aplikantët që nuk përfshijnë bashkëfinancim në propozim nuk do të merren në konsideratë.

Aplikantët inkurajohen të japin kontribute në natyrë; megjithatë, meqë ato nuk përfshijnë shpenzime në para për përfituesit e grantit, nuk do të trajtohen si bashkëfinancim. “Në natyrë” nënkupton investimin e bërë në formë të mallrave dhe shërbimeve, në vend të parave.

10. Qasja sistemike

Ndryshe nga qasja e zakonshme e donatorëve në Kosovë, e cila zakonisht përqendrohet në financimin e kompanive individuale për ta rritur konkurrueshmërinë e tyre, GPEK vepron ndryshe. GPEK nuk financon ose mbështet nisma të hartuara vetëm për ta përmirësuar performancën apo konkurrueshmërinë e një biznesi ose subjekti të vetëm. Megjithatë, GPEK mund të angazhohet me kompani individuale kur përmirësimet e arritura pritet të krijojnë përfitime më të gjera në tërë sektorin.

GPEK financon vetëm nisma ku aplikantët mund të dëshmojnë se aktivitetet e tyre të propozuara do të nxisin ndryshime domethënëse sistemike brenda sektorit përkatës. “Ndikimi sistematik” në këtë kontekst nënkupton se përfitimet e aktiviteteve të propozuara shtrihen shumë përtej një organizate ose partneri të vetëm. Aplikacionet e fuqishme do të paraqesin një arsyetim të qartë dhe bindës për llojin dhe shkallën e ndryshimit sistematik që pritet të rezultojë nga partneriteti me GPEK-un, që krijon impakt ekonomik, ambiental dhe social.

Për të vlerësuar nëse një ndërhyrje e propozuar kualifikohet si sistemike, aplikantët mund t'i marrin parasysh pyetjet në vijim:

- A do të përfitojë nga ndërhyrja një gamë e gjerë akterësh, subjektesh ose kompanish — dhe jo vetëm një?
- A do të nxisë ndryshime të sjelljes te një numër i madh i akterëve të tregut, duke i frymëzuar të tjerët të përvetësojnë praktika të reja?
- A do t'i mundësojë një partneri të pilotojë ose testojë një produkt apo shërbim të ri?
- A do të ndihmojë në vendosjen e një norme të re të sjelljes konkurruese brenda sektorit?
- A do t'u sigurojë akterëve të tregut qasje më të mirë dhe më të qëndrueshme në informacionet e tregut?

11. Rezultatet kryesore të dëshirueshme

Aplikacionet e dorëzuara në kuadër të kësaj thirrjeje duhet të dëshmojnë se si kërkesat e tyre për financim dhe aktivitetet e propozuara kontribuojnë në së paku një nga treguesit e rezultateve më poshtë.

Ndonëse aplikacionet vlerësohen nga disa këndvështrime, ato që dëshmojnë qartë potencial më të madh për ndikim në një ose, mundësisht, më shumë tregues të rezultateve, duke qenë kushtet e tjera të barabarta, do të kenë më shumë gjasa të marrin financim.

- Rritja e inovacioneve/teknologjive të gjelbra.
- Rritja e numrit të certifikimeve përkatëse të gjelbra të fituara.
- Rritja e vendeve të punës, përfshirë për gratë, të rinjtë dhe pakicat.
- Rritja e numrit të individëve që përfundojnë trajnime përkatëse për industrinë.
- Rritja e disponueshmërisë së mundësive të financimit për kompanitë (ESG, financim me kapital etj.).
- Rritja e digjitalizimit të kompanive.

12. Procesi i aplikimit

Kjo mundësi financimi do të përfshijë një proces aplikimi dhe vlerësimi me disa faza.

Faza 1: Dorëzimi i Shprehjes së Interesit (koncept dokumentit)

Gjatë fazës së parë, aplikantëve u kërkohet të dorëzojnë Shprehjen e Interesit (ShI), ku përmbledhet problemi që synohet të trajtohet, rëndësia e aktiviteteve të propozuara për qëllimet e GPEK, përshkrimi i aktiviteteve dhe detyrave kryesore të propozuara, ndikimi sistemik i pritshëm, rezultatet e pritshme (duke përshkruar se si rezultatet kontribuojnë në treguesit e rezultateve të projektit), plani i menaxhimit, përvoja e mëparshme përkatëse e aplikuesit dhe buxheti fillestar i propozuar. ShI-ja duhet ta shpjegojë qartë dhe në mënyrë të përmbledhur qëllimin, rëndësinë, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit të propozuar të grantit në mbështetje të objektivave të GPEK-ut të përcaktuara në këtë thirrje. Të gjitha ShI-të duhet të dorëzohen në formatin e ShI-së të përfshirë në këtë thirrje.

Aplikantët duhet t'i dorëzojnë ShI-të me shkrim ekipit të Fondit për Inovacionit të GPEK në mënyrë elektronike, përmes emailit në gpekgrants@helvetas.org jo më vonë se më 31 janar 2027, ora 16:00 (CET). ShI-të e dorëzuara pas kësaj date dhe ore nuk do të merren në konsideratë në kuadër të kësaj thirrjeje.

GPEK do të themelojë Komisionin për Vlerësimin e Granteve (KVG), i cili do t'i vlerësojë në vazhdimësi ShI-të e dorëzuara në përgjigje të kësaj mundësie financimi. ShI-të do të vlerësohen në bazë të kriterëve të përcaktuara më poshtë. Nëse ShI-ja e aplikuesit pranohet nga KVG-ja, aplikanti do të ftohet ta dorëzojë Aplikacionin e Plotë për Grant, siç përshkruhet më poshtë.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

- Formulari i ShI-së;

- Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Certifikata Fiskale/Tatimore;
- Struktura e pronësisë dhe menaxhimit me CV-të e stafit kyç.

Faza 2: Dorëzimi i Aplikacionit të Plotë për Grant

Pas vlerësimit të ShI-ve, GPEK do t'i ftojë organizatat që kanë dorëzuar ShI të suksesshme ta dorëzojnë Aplikacionin e Plotë për Grant (APG), bazuar në konceptin dhe qasjen teknike të propozuar në ShI. Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen sipas Formatit të Aplikacionit të Plotë për Grant të ofruar nga ekipi i GPEK. Format i APG-së kërkon që aplikuesit ta shtjellojnë hollësisht aktivitetin e propozuar të grantit, objektivat, ndikimin sistemik dhe rezultatet e pritshme, përfshirë përshkrimin e përfituesve dhe palëve të synuara të interesit, strukturën e propozuar të stafit dhe buxhetin e hollësishëm të grantit. Aplikacioni i Plotë për Grant nuk duhet të tejkalojë 15 faqe.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

- Formulari i Propozimit të Plotë (do t'u ofrohet aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë);
- Buxheti i hollësishëm (formulari do t'u ofrohet aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë);
- Pasqyrat financiare (2 vitet e fundit);
- Të dhënat e llogarisë bankare; dhe
- Dokumentet shtesë mbështetëse (sipas kërkesës).

13. Kriteret e vlerësimit

GPEK do të themelojë Komisionin për Vlerësimin e Granteve (KVG), i cili do t'i shqyrtojë në vazhdimësi ShI-të dhe APG-të e dorëzuara në përgjigje të kësaj mundësie financimi. Përparësi u jepet projekteve që fusin teknologji, procese ose modele të reja biznesi përtej praktikës së zakonshme. KVG-ja do t'i vlerësojë ShI-të dhe APG-të në bazë të kriterëve në vijim:

Kriteret (%)	Përshkrimi
Rëndësia për objektivat e GPEK dhe Taksonominë e WB6 (20%)	Aktiviteti, qëllimet dhe objektivat e propozuara të grantit janë në përputhje me objektivat e Projektit GPEK (d.m.th. eficienca e burimeve, energjia e ripërtëritshme, ekonomia qarkore, pajtueshmëria) dhe me aktivitetet e gjelbra të pranueshme sipas WB6, si dhe kontribuojnë në një ose më shumë objektiva mjedisore
Arsyetimi i biznesit dhe qëndrueshmëria financiare (20%)	Besueshmëria e modelit të biznesit, kostot realiste, bashkëfinancimi
Fizibiliteti teknik dhe zbatimi (20%)	Aktivitete, afat kohor dhe faza të qarta të zbatimit, zbutja e rrezikut, shtrembërimi i tregut
Mundësia për zgjerim, ndikimi sistematik dhe vlera shtesë (20%)	Potenciali për replikim, rëndësia për tregun, qëndrueshmëria pas grantit, vlera shtesë
Kapaciteti dhe përvoja (10%)	Përvoja e dëshmuar, kapaciteti i ekipit, menaxhimi financiar
Efektiviteti i kostos (10%)	Efikasiteti i kostove në raport me rezultatet e pritshme
Gjithsej 100%	

Nëse KVG-ja e pranon ShI-në në bazë të kriterëve të mësipërme, GPEK do ta njoftojë aplikantin me shkrim dhe do ta ftojë organizatën ta dorëzojë Aplikacionin e Plotë për Grant. Afati për APG-në do t'i komunikohet aplikantit të suksesshëm kur të njoftohet për pranimin e ShI-së. KVG-ja do ta vlerësojë APG-në sipas kriterëve të renditura më sipër.

GPEK rezervon të drejtën ta refuzojë cilindo ose të gjitha aplikacionet e pranuar, nëse ky veprim është në interesin më të mirë të donatorëve. Aplikacionet dorëzohen me rrezikun e aplikantit; nëse rrethanat e pamundësojnë dhënien e grantit, të gjitha kostot e përgatitjes dhe dorëzimit mbulohen nga aplikanti.

Aplikuesit në listën e ngushtë i nënshtrohen gjithashtu verifikimit të hollësishëm, i cili mbulon kapacitetin organizativ, gjendjen financiare, fizibilitetin teknik, arsyetimin e biznesit, ndikimin mjedisor dhe vlerën shtesë.

14. Asistenca teknike për aplikantët në listën e ngushtë

Aplikantët në listën e ngushtë mund të marrin Asistencë Teknike (AT) të synuar për t'i fuqizuar propozimet e tyre të plota në bazë të shqyrtimit të KVG-së. Ekspertët e AT-së mund të ndihmojnë në përsosjen e zgjidhjes teknike, fuqizimin e supozimeve financiare, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe strukturimin e planeve të zbatimit. Mbështetja me AT është vetëm këshilluese dhe nuk garanton financim.

15. Aplikimi për grant, vlerësimi dhe zbatimi

#	Procesi	Përshkrimi
1	Shpallja e thirrjes	Njoftimi publik, sesionet informuese, pyetje dhe përgjigje
2	Dorëzimi i ShI-së	Aplikantët dorëzojnë konceptin e shkurtër dhe dokumentet mbështetëse
3	Verifikimi i pranueshmërisë dhe përzgjedhja e listës së ngushtë	Shqyrtimi i kriterëve minimale; pikëzimi i ShI-ve të pranueshme; aplikuesit në listën e ngushtë ftohen në fazën e APG-së
4	Propozimi i plotë	Propozimi i hollësishëm, buxheti dhe plani i zbatimit
5	Verifikimi i hollësishëm	Vlerësimi financiar, teknik dhe organizativ
6	Vlerësimi përfundimtar	Shqyrtimi nga KVG-ja; i nënshtrohet vetos së donatorit
7	Kontraktimi	Nënshkrimi i marrëveshjeve të grantit
8	Zbatimi	Disbursimet e bazuara në piketa dhe monitorimi i vazhdueshëm
9	Përfundimi/Mbyllja e grantit	Pas përmbushjes së suksesshme të të gjitha piketave dhe rezultateve të përcaktuara në marrëveshjen e grantit, GPEK e konfirmon grantin si të zbatuar me sukses.